



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 24.11.2022, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Rita Zeqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Liridon Selmani, (PDK) dhe Trieria Kasumi-Berisha (LVV).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Faqe 1 nga 15

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit dhe hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Arbër Sadiku**, drejtor propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014.

**Përparim Rama**, kryetar propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Propozimvendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015.

**Endrit Zabërgja** tha se kur jemi në prag të festës kombëtare që simbolizon ditën e bekuar të kombit shqiptar dhe pranë 15 janarit që shënon ditën e gjenocidit të ndodhur në Kosovë, propozoi që si pikë rendit të ditës të hynë: Propozimvendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

**Milazim Vitija** propozoi që në rend të ditës të hynë edhe propozimi: Propozimvendimi për lirim të të gjithë personave fizikë dhe juridikë nga obligimi për tarifën në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.

**Gëzim Sveçla** tha se i përkrahim propozimet e z. Vitija dhe Zabërgja, por kemi nevojë për argumente shtesë, informata shtesë se pse po na kërkohet ta shfuqizojmë një rregullore, dihet që procedura për miratimin e një rregullore është bajagi një far procedure e gjatë dhe e komplikuar, në anën tjetër për shfuqizim po na sillen 5 minuta para seancës, pa i pasur informatat e mjaftueshme. Nuk është kompetencë e Kuvendit Komunal çështja e vlerësimit të pronave, kjo është jashtë kompetencave të Kuvendit, dhe si të tillë e shoh të kotë nëse e largojmë nga rendi i ditës.

**Gëzim Mehmeti** kërkoi nga ekzekutivi i Komunës, në veçanti nga kryetari që të jenë më kompetent me veprimet e tyre, kryesisht rreth pikave të rendit të ditës të cilat po sillen në Kuvend pa material dhe po kërkohet votimi i tyre. Lidhur me këtë kërkoi që kjo praktikë të ndërpritet dhe të mos përsëritet.

**Leutrim Retkoceri**, propozoi që pika e dhjetë e rendit të ditës ( Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/23), të zhvendoset, të jetë pika e katërt e rendit të ditës, për arsye se drejtorja e drejtorisë cila do ta prezantojë këtë informatë ka një takim me ekspertë britanik.

**Muhamet Selmani**, tha se pika e gjashtë e rendit të ditës që ka të bëjë me Propozimvendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, kërkoi që tarifën për tatim për parcelat bujqësore edhe objektet bujqësore të mos aplikohet së paku edhe këtë vit, për arsye të gjendjes të cilën e kemi dhe subvencionimin e vazhdueshëm që jemi duke bërë në bujqësi dhe nëse votohet si dokument dhe si njësi matëse për këto tatime të mos futet në zbatim për vitin 2023.

**Leutrim Retkoceri** tha se si GP e kemi analizuar me vëmendje Propozimvendimin për caktimin e normave tatimore, për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, kështu që krahasuar me vitin paraprak, nivelet e vlerave të tatimit në pronë ky propozimvendim i ka jashtëzakonisht të larta dhe të pa përballueshme. Rritja enorme e vlerave të tatimit në pronën e paluajtshme nga raportet e përgjithshme të vlerësimit, pa analizuar gjendjen e rëndë ekonomike që kalon dhe është duke kaluar vendi dhe pa diskutuar me qytetarë është e pa pranueshme. Kërkoj që kjo pikë të del në propozim për tërheqje nga pikat e rendit të ditës, ti kthehet Ministrisë së Financave dhe Transfereve, për përmirësim dhe vlerësim të saktë.

**Donjeta Dragusha** tha se edhe ne si GP e kemi analizuar këtë propozimvendim dhe konsiderojmë që vlerësimi është tejet i lartë, duke e pa edhe krizën që e ka kapluar gjithë vendin edhe ne e përkrahim që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës, me kërkesën që Ministria e Financave të bëjë edhe një rivlerësim për pronat e paluajtshme në Komunën e Prishtinës.

**Fiknete Bejta** tha se si një ekonomiste që jam, këtë Propozimvendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, e përkrahi në mënyrën më të sinqertë për largimin nga pika e rendit të ditës, që duke e pa këtë inflacion të lartë edhe nga mos funksionalizimi i zbatimit të projekteve nga niveli qendror që janë planifikuar në vitin 2022, dhe nuk ka asnjë arsye të tentojmë të vjelim më shumë mjete nga qytetarët për ti bllokuar ato. Si asambliste nuk votoj për me u rrit asnjë normë tatimore në këto kushte ekonomike çfarë jemi.

**Osman Bllaca**, i hodhi në votim propozimet e dhëna, që ato të hyjnë në rend të ditës.

**Kryesuesi** konstatoi se më 26 vota për, 15 kundër dhe 3 abstenime, hynë në rend të ditës: Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri më 44 vota për, hynë në rend të ditës: Propozimvendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015.

**Kryesuesi** konstatoi se më 39 vota dhe 1 kundër, hynë në rend të ditës: Propozimvendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

**Kryesuesi** konstatoi se më me 43 vota për dhe 2 abstenime, hynë në rend të ditës: Propozimvendimi për lirimin e të gjithë personave fizikë dhe juridikë nga obligimi për tarifën në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.

**Kryesuesi** konstatoi se më 23 vota për dhe 12 kundër, pika 10 e rendit të ditës (Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/2023) bartet në pikën 4 të rendit të ditës.

**Kryesuesi** konstatoi se më 27 vota për, 10 kundër dhe 4 abstenime, hiqet nga rendi i ditës: Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.

Me ndryshimet dhe plotësimet e miratuara, kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 11 abstenime u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonë lagjes "Kalabria";
3. Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës;
4. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;
5. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina ", sipas kërkesës së rektorit të UP- së në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit;
8. Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje;
9. Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi;
10. Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014;
11. Propozimvendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015;
12. Propozimvendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë;
13. Propozimvendimi për lirim të të gjithë personave fizikë dhe juridikë nga obligimi për tarifën në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 6 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit.

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”**

Lidhur me Propozimvendimin për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Gëzim Sveçla** tha se po e bëjmë një veprim që nuk ka qenë fare i nevojshëm me ardhë në Kuvend dhe se inicimi i planeve nuk është i nevojshëm të silltet në Kuvend, çka nëse nuk kalon inicimi sot, a do të thotë kjo që Kalabria do të mbetet pa planin e vet. Mendoj se ky propozimvendim është sa për të marrë kohë, për të ulur presionin e arsyeshem që vije nga banorët e lagjes. Edhe përkundër kësaj ne do ta votojmë për miratim, por duke kërkuar seriozitet dhe respektim të ligjeve dhe dispozitave ligjore në fuqi, në mënyrë që temat e njëjta të mos na kthehen shumë herë në këtë Kuvend. Produktiviteti i Kuvendit është shumë i ulët dhe në vend që të jemi shembull për kuvendet komunale tjera, jemi kampion në vendime të paligjshme.

**Amir Simnica** tha se ne si GP i LDK-së e përkrahim për miratim Propozimvendimin për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për lagjen “Kalabria”.

**Leutrim Retkoceri** tha se edhe ne e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi dhe uroj që punët dhe shpejtësia në këtë plan të jenë vendimtare dhe të jenë prioritete që sa ma herët të vjen në Kuvend votimi i këtij plani.

**Bahri Gashi** tha se është dashtë që të na prezantohet një historik i shkurt i këtij plani, se si ky vendim ka ardh dhe si është shfuqizuar prej pushteti dhe opozita e ka përkrahë dhe do ta përkrahë edhe sot, pra GP i AAK-së e përkrah këtë propozimvendim për miratim.

**Gëzim Mehmeti** tha se ka qenë premtim i ekzekutivit se në shtator do ta kemi këtë plan, kështu që janë bllokuar ata qytetarë dhe nuk kanë të drejtë ta gëzojnë të drejtën e tyre primare rreth ndërtimeve, edhe pse kanë hy në marrëveshje kontraktuale. Anulimin e këtij propozimplani ne e kishim kundërshtuar dhe e konsideruam si të kundërligjshëm.

Mendoj se edhe në vitin 2023 do të shkoj e njëjta procedurë dhe nuk do të ketë mundësi të rregullohet kjo çështje, dhe pasi që kemi mundësi ligjore, kërkoj që mos të jetë propozim për hartim por të jetë harmonizim i planit rregullues.

**Endrit Zabërgja** tha se edhe ne i mbështesim kërkesat e qytetarëve të lagjes “Kalabria”, dhe e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës, me urimin që sa ma shpejtë të zgjidhet halli i qytetarëve dhe të mund të funksionojnë ashtu siç ja u përcakton çdo e drejtë njerëzore, për shfrytëzimin e pronës së vet.

**Arianit Beqiri**, rreth këtij propozimplani ngriti shqetësim i cili tha se nga muaji prill kur është diskutuar për këtë hapësirë, a është lëshuar ndonjë leje ndërtimore në atë pjesë, e cila potencialisht mund të bie ndesh me planin e ri që mund të jetë plani rregullues. Po ashtu tha se kur mundemi me e pa një draft të parë të planit rregullues dhe a do të ketë dëgjim publik.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Arbër Sadiku, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 47 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria".**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës.**

Lidhur me Propozimvendimin për ndarjen e subvencioneve të administratës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar.

**Rita Zeqiri** tha se ne si GP e përkrahim këtë propozimvendim për ndarjen e subvencioneve të administratës me vlerë prej 360.000 euro nga kategoria e subvencioneve dhe transferove, por kemi një vërejtje gjatë kohës së ndarjes së subvencioneve për sport. Ne duhet të kemi kujdes apo edhe të kufizojmë ndarjen e subvencioneve ndaj OJQ-ve të cilat edhe me rregulloren e tyre të brendshme por edhe me ligj fushë veprimtaria e tyre shtrihet në nivel nacional, sepse nuk kemi asnjë garanci që ata do të zhvillojnë aktivitete apo ato mjete do të ndahen për aktivitete që zhvillohen brenda territorit të Prishtinës. Po ashtu do të ishte mirë që të sqarohet për opinionin se a janë këto kërkesat e vetme të cilat u janë drejtuar apo ka pasur më shumë kërkesa dhe a ekziston ndonjë prioritet në ndarjen e këtyre mjeteve nga kategoria e subvencioneve.

**Driton Rukiqi** tha se edhe ne si GP i LDK-së e përkrahim për miratim këtë propozimvendim për ndarjen e subvencioneve për të gjitha këto kategori.

**Leutrim Retkoceri** tha se edhe ne si GP e përkrahim për miratim këtë propozimvendim për ndarjen e subvencioneve.

**Kushtrim Mushica** tha se edhe ne si GP i AAK-së e përkrahim për miratim këtë propozimvendim për ndarjen e subvencioneve, me një theks të veçantë për propozimet e sportit që këto klube dhe federata do të mbajnë aktivitete në Prishtinë dhe për sukseset që i kanë treguar sidomos klubi i Hajvalisë -femrat, që kanë arritur të marrin pjesë në Champions League.

**Gëzim Mehmeti** tha se edhe ne si GP i AKR-së e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Endrit Zabërgja** tha se në emër të Nismës Socialdemokrate e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Gëzim Sfeçla** tha se parimisht e përkrahim këtë propozimvendim, por për hirë të transparencës dhe për hirë të opinionin, kemi nevojë për disa sqarime shtesë: Si ka ardhur deri te këto subvencione, a ka pasur thirrje publike; A është formuar komision për ndarjen e këtyre subvencioneve; Cilat kanë qenë kriteret që janë ndarë këto subvencione; A është e lejuar që me taksa të taksapaguesve të Prishtinës të paguhen federata ose organizata të nivelit qendror të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në tërë Kosovën; Cilat kanë qenë kriteret për ndarjen e këtyre subvencioneve; A kemi të drejtë me përkrahë organizata, OJQ ose federata që janë të nivelit qendror.

**Rashit Gashi** tha se përveç këtyre kërkesave që janë përfshirë në këtë propozimvendim, a ka pasur kërkesa tjera dhe si është bërë përzgjedhja, sepse ne e dimë kemi marrë së paku edhe kërkesa tjera të cilat kanë qenë nga muaji i kaluar dhe nuk janë përfshirë në këtë vendim.

**Berna Saraçi** tha se a ka pasur thirrje të hapur për këto kërkesa dhe subvencione që janë bërë apo është si mundësi për qytetarët e Prishtinës që ata vetëm me dërgua kërkesë edhe munden me qenë përfitues të përfitimeve të tilla, kështu që ndoshta kishte me qenë mirë me qenë transparent edhe në këtë pikë.

**Nora Kelmendi** tha se në bazë të rregullores a keni bërë thirrje publike për me ditë të gjithë banorët e Prishtinës, dhe në bazë të ç' kafit po doni mi dhënë këto subvencione. Kërkojmë një opinion nga Zyra ligjore që të na e sqaron se si ka ardhur në Kuvend ky vendim në mënyrë të rregullt apo jo.

**Arianit Beqiri** shprehu një shqetësim duke cekur se, njerëzit të cilët aplikojnë në Komunë edhe kërkojnë mbështetje dhe shohin sot që kemi ndarë para, nesër vinë studentët edhe thonë që jemi duke studiuar qoftë në Kosovë, qoftë diku tjetër dhe kemi nevojë për para, pra mendoj se jemi duke krijuar një precedent që jemi duke dhënë para ndoshta pa asnjë kriter dhe pa e dit se qysh po i ndajmë këto mjete.

**Bahri Gashi** tha se ne po pajtohemi që me ju ndihmua të gjithëve, edhe ndoshta më shumë me bërë, po mënyrat, rregullat dhe format qysh ka ardhur deri këtu nuk qëndrojnë. Si mund të konkuroi vetëm një person dhe pse të tjerët nuk e kanë ditë më konkuroa, kështu që do të ishte mirë të jetë më transparente. Ne këtu jemi për të ndihmuar, si grup i Aleancës jemi për me përkrah edhe me rritë po të paktën me ditë qysh ka ardhur deri aty.

**Fiknete Bejta** tha se nëse kërkohet që të votohet për secilin vendim për secilën kategori të ndarjes, atëherë duhet ti kemi 12 pika të rendit të ditës të ndryshme, pra për një vendim të ndryshëm nuk mundemi me pas një pikë të rendit të ditës dhe mendoj se si procedurë do të ishte e gabuar, prandaj dhe mendoj se kryetari ka të drejtë me subvencionua secilën kategori, faktikisht këtu janë të sqaruara në këtë propozimvendim.

**Petrit Reçica** `tha se kjo është një temë shumë e ndjeshme, ose të jetë si pikë e fundit të rendit të ditës deri sa të kompletohet dokumentacioni, ose po e shtyjmë për mbledhjen e ardhshme. Ne do ta votojmë, por problemi është që na e kthen Ministria, prandaj do të ishte mirë që dokumentacioni të rregullohet dhe ta votojmë, pasi që të plotësohet dokumentacioni.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, Granit Rugova, drejtor dhe Arben Kçira, zyrtar i Zyrës ligjore.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 39 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës.**

#### **Pika e katërt**

#### **Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022-2023**

Lidhur me Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022-2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Besianë Musmurati, drejtore.

**Berna Saraçi** tha se po ti referohemi kësaj informate konkretisht aty ku ceket për ambiente të sigurta dhe miqësore, mendoj që nuk mundemi me folur plotësisht për ambiente të sigurta dhe miqësore për derisa oborret e shkollave janë totalisht të hapura dhe lehtësisht kanë qasje kush do në ato shkolla. Ka mungesë të skajshme të tualetëve për përdorues të karrocave, nuk kemi ujë në institucione tona shkollore etj. Po ashtu kërkoi të dijë se qysh janë bërë vlerësimet dhe ku janë sistemuar ata asistent të rijë që janë punësuar si asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Ajet Brajshori** tha se e vlerësoj shumë një punë të mrekullueshme që ka bërë Drejtoria e Arsimit me të dhënat që na ka ofruar por gjithmonë mbetet për të pasur hapësirë me i analizuar edhe në hapat e më tutjeshëm që të kemi një proces të mirë të mbarëvajtjes në shkolla tona.

Informata për të filluar vitin e ri shkollor janë shfrytëzuar të gjitha mjetet dhe të dhënat nga shkolla dhe mendoj është bërë një hap i mirë që ta analizojmë situatën dhe të gjitha këto përgatitje janë bërë në mbështetje të obligimit ligjor që ka drejtoria dhe Komuna për t'i përgatitur shkollat, në pikëpamje fizike dhe profesionale, për të filluar vitin e ri shkollor. Si punëtor i arsimit mendoj se duhet të punojmë në vlerësime sa më objektive, kemi shumë instrumente për të ardhur të një vlerësim objektiv, por kjo normalisht është detyrë e drejtorisë për me i monitoruar vazhdimisht dhe me e shikuar gjendjen, sidomos është detyrim i shkollave që vlerësimin ta bëjnë mësimdhënësit me shumë instrumente, me shumë mjete metodologjike mjete teknike të arsimit etj.

**Leutrim Retkoceri** tha se gjendja e arsimit në Kryeqytet ka nevojë shumë të madhe për punë, angazhim, institucione, investime kapitale në çerdhe, në shkolla, mirëpo këto informata besoj që do të na shërbejnë dhe do të na përcjellin edhe me suksese tek nxënësit. E përshëndes punën dhe angazhimin që po bëhet tashmë nga Drejtoria e Arsimit dhe uroj në suksese të më tutjeshme.

**Valbona Ajeti** tha se te Plani i punës nëntë mujor që na u prezantua, kërkoi të dijë se tek projekti individual i dollapëve për klasat 1 - 5 a kish pasur mundësi që këta dollapë të shtohen edhe për klasat 6 - 9, ku prindërit vet po i blejnë e po i sjellin për shkak të mbipeshës së çantave të fëmijëve. Po ashtu përshëndes iniciativën e rekrutimit të psikologëve për çdo shkollë, pasi që është e nevojshme që çdo shkollë të ketë psikolog.

**Sami Boroci** tha se zgjedhja e drejtorëve në disa shkollave në këtë rast shkolla fillore "Hasan Prishtina" është zgjedhë drejtor i kësaj shkolle dhe e ka kthyer ministria në pikën zero. Pse ka ndodhë kjo.

**Endrit Zabërgja** e përgëzoi drejtoreshën për informatën e dhënë, me ç'ras konsideroi që është duke u bërë një punë pak më ndryshe dhe uroi që të vazhdohet në mënyrë që arsimit në Prishtinë të ketë një pamje tjetër, krahas asaj se çfarë na është premtuar.

**Fikente Bejta**, lidhur me informatën e prezantuar tha se kam dy shqetësime:

Si shqetësim që vlen të veçohet është numri i madh i nxënësve që kanë braktisur shkollën në këtë vit e që shihet se është dukshëm i rritur, kështu që kërkoi të dijë se a ka ndonjë raport drejtoria për këtë fenomen. Si shqetësim tjetër është vlerësimi që ndodh si proces i avancimit të arsimit, vlerësimi i nxënësve për mësimdhënësin, ne e dimë që në ciklin para universitar nuk ka shumë metoda që bëhet vlerësimi i mësimdhënësve nga fëmijët, mirëpo mundësia e vetme e monitorimit të tyre ndaj mësimdhënësve është kutia e ankesave dhe këto kutia pothuajse nuk po hapen asnjëherë, kështu që si shqetësim është që zëri i fëmijëve nuk merret për bazë në disa shkolla.

**Ermal Osmani** tha se ka shumë kritika dhe ankesa nga prindërit se në shkollën "Hasan Prishtina", kundërmon erë e rëndë që vjen nga wc-ja e shkollës dha a është ndërmarrë ndonjë masë për sanimin gjendjes. Po ashtu a do të merrni ndonjë masë për rregullimin e sallës së edukatës fizike në shkollën "Naim Frashëri", e cila është në një gjendje katastrofike.



**Rashit Gashi** tha se Drejtoria e Arsimit bashkë me kryetarin e Komunës ka marrë një vendim në lidhje me pagesën e transportit të fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët vijojnë shkollën, çerdhen dhe do të jenë përfitues të kësaj ndihme. Lidhur me këtë kërkoi të dijë se si ka me qenë mënyra e përfitimit të kësaj shume, a do të përfitojnë edhe ata fëmijë të kësaj kategorie që nuk janë në çerdhe, nuk janë në shkolla, ose që janë në shkolla private.

**Feim Osmani** tha se ka shumë shkolla që nuk kanë salla të edukatës fizike, kryesisht në shkollat e fshatrave e që kjo ndikon negativisht edhe në aspektin e shëndetit fizik, mirëpo edhe në plotësimin e përgjithshëm të kurikulës. A është punuar në këtë drejtim që krahas digjitalizimit edhe kjo çështje të jetë prioritare, pa marrë parasysh numrin që në disa shkolla mund të jetë numër i vogël i nxënësve.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Besianë Musmurati, drejtore.

### **U konstatua se u përkrah Informata për fillimin e vitit shkollor 2022-2023**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane**

Për Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Bersant Beka, drejtor.

**Gëzim Sveçla**, për anëtar të komisionit nga GP i LVV-së propozoi Feim Osmanin.

**Donjeta Dragusha**, për anëtar të komisionit nga GP i LDK-së propozoi Jeta Rafuna Hasani.

**Granit Geci**, për anëtar të komisionit nga GP i PDK-së propozoi Leutrim Retkocerin.

**Bahri Gashi**, për anëtar të komisionit nga GP i AAK-së propozoi Valbona Vitia.

**Endrit Zabërgja** tha se para votimit të këtij komisioni uroj që procesi i zgjedhjeve të bashkësive lokale të fillojë sa më parë e të përfundojë me sukses, duke e ditë që një kohë shumë të gjatë ka pas një pasivizim të këtyre bashkësive lokale.

**Feim Osmani** tha se komisionit i nevojitet një proces mbajtës dhe sigurisht që proces mbajtësi nuk mund të zgjidhet përmes Kuvendit, mirëpo unë kisha sugjeruar që me një vendim të drejtorit të Drejtorisë së Administratës ose të Kuvendit të caktohet një procesmbajtës.

**Osman Bllaca** tha se anëtar i këtij komisioni nga ekzekutivi do të jetë Bersant Beka, drejtor, si dhe një përfaqësuesi i BL aty ku mbahen zgjedhjet.

**Kryesuesi konstatoi se më 49 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina', sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë.**

Lidhur me Propozimvendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtoare.

**Nora Kelmendi** ngriti shqetësim rreth dhënies së pronave komunale në shfrytëzime cila ceku se pronat të cilat nuk janë në listën e veçantë as në listën e përgjithshme të pronave komunale gjatë vitit 2022, nuk jepen në shfrytëzim. Edhe kjo pronë me nr. 735-1, nuk mund të jepet për shfrytëzim, pasi që nuk e keni në listë, ndoshta këtu edhe mund të votohet, por Ministria prapë do ta kthen.

**Lindita Rexhepi** tha se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për ndërtimin e fakulteteve ka për qëllim përmirësimin e kualitetit të studimeve përmes sigurimit të hapësirave adekuate, bashkëkohore, universitare për akomodimin e studentëve të Fakultetit Teknik dhe Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore dhe të Fakultetit Ekonomik. Ne si GP i LDK e përkrahim për miratim.

**Arianit Beqiri** tha se kjo pronë që na është sjellë duhet me qenë në listën e pronave për shfrytëzim dhe nuk është dashtë të sillet në Kuvend, prandaj ky është problemi kryesor pastaj këtu nuk ka kurrfarë ndikimi as nga kjo sallë as nga diku tjetër por vetëm po flasim për diçka të cilën sa herë që e kemi dokumentuar që është ashtu, ashtu ka dal kjo është e vërteta.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 17 abstenime, umiratua Vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina', sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit**

Lidhur me këtë propozimvendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

**Arbër Vokri** tha se ngritja e statusit juridik të kësaj njësie do ti shërbej përmirësimit të cilësisë së punës, por edhe shtimit të gamës së shërbimeve që i ka ajo poliklinikë. Si grup i LVV-së gjithsesi se do ta mbështesim themelimin e kësaj poliklinike.

**Fiknete Bejta** tha se natyrisht që është lajm shumë i mirë themelimi i Poliklinikës Stomatologjike të Kryeqytetit dhe kjo po e rrumbullakson ngritjen e infrastrukturës së nivelit të shëndetit dytësor dhe si strategji që të forcoj shërbimet diagnostifikuese në aspektin e shërbimeve sekondare e që është një prej hapave më të mirë që mund të ndodh në Kryeqytetin tonë.

**Kumrije Shabani - Ramadani** tha se është një vendim i rëndësishëm për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike që do të rris kapacitetet për shërbime shëndetësore stomatologjike për çdo qytetarë të Prishtinës. Qëllimi kryesor i poliklinikës së qytetit është që të ofrojë kujdes mjekësor të përgjithshëm.

**Bahri Gashi** tha se edhe ne si GP e përkrahim themelimin e kësaj poliklinike mendoj se është punë shumë e mirë. Prishtina ka nevojë për më shumë jo vetëm për një poliklinikë, kështu që shpresojmë se do të rritet më shumë në të ardhmen numri i tyre.

**Sami Boroci** tha se edhe ne e përkrahim themelimin e kësaj poliklinike e që shpresoj që shpejt do ta themelojmë edhe Spitalin e qytetit me një vendim të tillë të Kuvendit.

**Endrit Zabërgja** tha se edhe ne po ashtu e përhëndesim këtë vendim për miratim.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 39 vota për, u miratua Vendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje**

Lidhur me këtë propozimvendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Adelina Sahiti, drejtore.

**Violeta Salihu** tha se grupi i LVV-së në parim e përkrah këtë propozimvendim, por kemi dy rekomandime: Propozojmë që te neni 2 të shtohet " Komuna në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, të organizoj një riaftësim profesional në mënyrë intensive për viktimat" sepse duke parë praktikat e vendeve të tjera, personat që e fitojnë këtë përkrahje financiare kanë obligim të riaftësohen me fushat d.m.th. me profesionet të cilat janë relevante me kërkesat e tregut në mënyrë që ndihma të arrij efektin e vet që ato pas kalimit të afatit 6 muaj deri 2 vjet të jenë të afta të punojnë dhe ti qasen tregut të punës.

Po ashtu duhet të rishikohet mundësia për rritjen e buxhetit për përkrahje financiare të viktimave.

**Elmire Nikçi - Rexha** falënderoi të gjithë akterët për këtë nismë në përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, përkrahjen e atyre grave dhe vajzave dhe në emër të grupit të LDK-së këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Shegë Beqiri - Badivuku** tha se edhe ne si GP e mbështesim këtë propozimvendim e që kjo ka qenë më se e nevojshme duke e ditur rritjen e rasteve të dhunës në familje. Në të ardhmen propozojmë që të rishikohet mundësia për përkrahje financiare për secilin fëmijë veç e veç duke pasur parasysh edhe çmimet e larta në treg.

**Endrit Gashi** tha se edhe ne si GP i AAK-së këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Arianit Beqiri** tha se duhet të bëhet përpjekje sa më shumë për lehtësimin në hapjen e xhirollogarive, mbase të krijohet një ekip që ju ndihmon grave të cilat i hapin xhirollogaritë. Po ashtu theksoi se strehimi i grave të dhunuara të jetë sa më kofidencial dhe duhet të kemi kujdes se ku po i strehojmë dhe përveç strehimit të ketë edhe siguri shtesë për ato.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 39 vota për, u miratua Vendimi për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje.

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Ilirik Musliu, drejtor.

**Gëzim Sveçla** tha se duke pasur për bazë planin për mobilitet të qytetit kjo rregullore në të ardhmen do të plotësohet edhe me amandamentimin ose ligjet e tjera të cilat kishin me i ndihmuar zhvillimit të transportit në një mënyrë dhe në anën tjetër me përkrah zhvillimin e qytetit. Mbetet pak diskutabile çështja e hapjes së tregut për taksi, licenca për shkak se ka mundësi që kjo pastaj të devijoj, të del jashtë kontrollit. Në përgjithësi parimisht e përkrahim dhe do të votojmë këtë projektregullore.

**Sami Salihu** tha se ne si GP i LDK-së e kemi analizuar këtë projektregullore dhe propozojmë që të ndryshohet tarifa, apo shuma nga 1.5 euro të bëhet në 1 euro në ditë dhe kërkojmë që me këtë propozim ta miratoni këtë projektregullore.

**Leutrim Retkoceri** tha se me këtë projektregullore do të rregullohen shumica e problematikave që sot qëndrojnë në Kryeqytet për taksi dhe shpresoj që në të ardhmen të shihen edhe forma dhe mundësi të tjera të mbështetjes së bizneseve apo personave individual në arritjen dhe plotësimin e kriterëve për përmbushjen e rregullores. E përkrahim për miratim këtë projektregullore.

**Bahri Gashi**, lidhur me këtë projektregullore tha se ne veç i kemi dhënë disa vërejtje, dmth që viti i prodhimit të mos jetë më shumë se 8 vjet, prandaj për një licencë është shumë problematike për 306 leje individuale që i ka dhënë Komuna e Prishtinës. Nëse do të bëhet kjo rregullore çka do të bëhet me ata taksistët individual dhe disa kompani të tjera do të dështojnë dhe ka me qenë problem social, prandaj dhe mendoj se me këtë rregullore rëndohet edhe keqësohet transporti i Prishtinës.

Aleanca këtë projektregullore nuk e përkrah dhe nuk do ta voton, ju kisha lutë dhe ju kisha bërë thirrje që ta mendoni pak më ndryshe dhe ta trajtoni pak më ndryshe, me ju dhënë mundësi njerëzve të paktën edhe disa vjet për ta bërë një automjet më të ri.

**Sami Boroci** tha se do të ishte mirë që Komuna ta ket parasysh që me i stimuluar këta 300 e sa janë taksi individual që të gjejë një bazë ligjore për blerjen e veturave të reja ose me i avancuar veturat qysh kërkohet. Edhe unë jam i pajtimit që duhet të kemi vetura të reja për shkak që duhet ta avancojmë këtë standard, këtë shërbim, por në anën tjetër duhet ta mendojmë ndoshta edhe aspektin social të këtyre 306 personave që potencialisht janë 300 familje e që secili prej nesh njohim edhe njerëz të tillë që mbajnë edhe familje me këtë veprimtari.

**Endrit Zabërgja** ishte i mendimit që krahas domosdoshmërisë për ta arritur një unifikim të funksionimit të taksive, duhet të bashkë ndiejmë edhe me rrethanat aktuale me të cilat sot po kalojnë qytetarët e Kosovës. Mendoj se me një rregullore të tillë qytetarët do ta kenë shumë të vështirë të funksionojnë sidomos taksitë privat, pra mos ti detyrojmë taksitë ti ndërrojnë makinat në këtë kohë kur po ballafaqohemi me krizë ekonomike.

**Ermal Osmani** tha se e përshëndesim këtë rregullore të re, por mendoj se shqetësimi i operatorëve është evident, pasi që kjo rregullore ka disa kritere të cilat i rëndojnë në masë taksistët individual dhe disa kompani të taksitëve.

**Feim Osmani** tha se ka qenë më se e domosdoshme që të bëhet një rregullore e re, sepse ajo e vjetra ka mangësi natyrisht të shumta. Mendoj se neni 10 pika 1.2 e cila e kufizon përvojën 5 vjeçare për ngasësit, për shoferët e taksive konsideroj se kjo diskriminon shtresën që ka nevojë më së shumti për punë siç janë studentët dhe mosha e re të cilët kanë kohë të shkurtë që janë pajisur me patentë shofer. Propozoi që kjo nga 5 vjet të zbret në 3 vjet. Po ashtu edhe tek neni 11 pika 2 tek tarifa për licencim, pagesa 300 euro për taksitë individual konsideroj që edhe kjo është diskriminuese për këtë kategori.

**Agim Kuleta** propozoi që taksitë që janë të licencuara tash të vazhdojnë me vetura të tilla deri sa të ju vjen koha, sepse vjen një moment kur duhet ti ndërrojnë ato vetura, sepse i humbin klientët me vetura të vjetra, le të vazhdojnë deri sa të vij koha ti ndërrojnë veturat e tyre, ndërkohë asnjë taksitë tjetër të mos licencohet pa i plotësuar kriteret që i parasheh rregullorja.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit sqarime shtesë dha Ilirik Musliu, drejtor.

**Kryesuesi** konstatoi se më 33 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi.

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014**

Për këtë propozimvendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

**Gëzim Sveçla** tha se ne i shprehim vërejtjet tonë për mënyrën se si ka ardhur deri këtu, për shkak të urgjencës me të cilën na është paraqitur si pikë e rendit të ditës.

**Sami Boroci** tha se duke e pasur parasysh arsyetimin që e dha drejtori do ta mbështes për miratim këtë propozimvendim, me shpresë që shumë shpejt do ta kemi një dokument të ri dhe përmbajtësor i cili i plotëson nevojat e drejtorisë.

**Endrit Zabërgja** tha se edhe ne në parim e mbështesim këtë propozimvendim për miratim. **Arbër Vokri** tha se nga arsyetimi i dhënë nga drejtori, u konstatua se pas kësaj do të miratohet një rregullore tjetër përmes të cilës do të veprohet për ato që janë aktuale do me thënë me pasojat që i ka lënë rregullorja të cilën sot po e shfuqizojmë. Kërkoi të dijë se çka bëhet pastaj me ato objekte që na kanë mbetur aty.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime shtesë dha Arbër Sadiku, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 12 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014.

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.201532221`

Gëzim Sveçla ngriti sheqetsim rreth këtij propozimvendimi duke cekur se ky harmonizim është dashur të bëhet më herët, në momentin kur është kthyer prej MAPL-së me ato vërejtje, pra edhe përkundë kësaj ne do ta votojmë për miratim.

Leutrim Retkoceri ishte i mendimit se është jashtëzakonisht e vështirë që në kësi situata të rregullohen dhe të harmonizohen ligjet që i takojnë nivelit qendror, mirëpo kjo çështje besoj që është e një prioriteti dhe karakteri të veçantë që duhet të rregullohet si çështje dhe të mos na përsëriten në të ardhmen.

Bahri Gashi tha se edhe ne si GP e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 44 vota për, u miratua Vendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.201532221.

#### **Pika e dymbëdhjetë**

Propozimvendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë

Endrit Zabërgja, falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit për mbështetjen e përbashkët që i dhamë kësaj iniciative, kështu që kërkoi që të procesohet me votim.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

#### **Pika e trembëdhjetë**

Propozimvendimi për lirimin e të gjithë personave fizik dhe juridik nga obligimi për tarifatat në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011

Lihur me këtë propozimvendim, arsyeshmërin për miratim e tij e paraqiti Milazim Vitija i cili tha se mbi 50% të banorëve të Komunës së Prishtinës, për shkak të taksës në transaksion nuk janë direkt pronar të paluejtshmërisë, e që në fakt janë. Pengesat e kësaj takse janë:

1. Nuk mund të merren kredi hipotekuese nëse nuk je pronar;
2. Nuk mund të realizohet e drejta e pasurisë, ndarja fizike, shfrytëzimbani, ndërtim, etj;
3. Nuk mund të realizohen subvencionime, përfitimi i granteve dhe donacionet, aplikimi për vizë;
4. Pagesat, tatimet e pronës, problemet financiare familjare kush, cili po e paguan etj.

Ju ftoi që ta votojmë shfuqizimin e kësaj takse në transaksion.

**Nora Kelmendi** tha se në mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës të mbajtur në maj, grupi i LVV-së ka kërkuar që të hy kjo pikë e rendit të ditës në të cilën do të shqyrtohet ligjshmëria e Rregullores të vitit 2011 dhe asaj të ndryshuar në vitin 2017, Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, në mënyrë që të hiqet kjo takse.

Taksa në transaksion përveç që është e jashtëligjshme ka paraqitur edhe ngarkesë tek qytetarët dhe ekonomitë familjare të cilët dëshirojnë ti regjistrojnë pronat e tyre. Më pas shtoi se GP i LDK-së e jetësoj iniciativën tonë që kjo të sillet në Kuvend për miratim. Ne do ta votojmë heqjen e taksës sikurse e kemi votuar edhe para 6 muajve kur ju e kundërshtuat që kjo të hy si pikë e rendit të ditës.

**Leutrim Retkoceri** tha se edhe ne e përshëndesim këtë vendim për suspendim të taksës për 1 vjet dhe mendoj që është mirë që janë analizuar edhe çështja e planifikimit të të hyrave buxhetore dhe është ardhur deri tek një opsion që nuk e dëmton as buxhetin dhe ju ndihmon edhe qytetarëve.

**Kryesuesi** konstatoi se më 38 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për lirimin e të gjithë personave fizik dhe juridik nga obligimi për tarifën në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.

#### **Pika e katërbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje**

**Kryesuesi** konstatoi se për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka asnjë diskutim.

#### **Pika e pesëmbëdhjetë Te ndryshme**

**Kryesuesi** konstatoi se për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka asnjë diskutim.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:00.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**



Faqe 15 nga 15